



KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare
Seanca nr.2003/26
Prishtinë, më 2 tetor 2003, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Xhavit **Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 105 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Kryesia i kishte propozuar Kuvendit këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.
2. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë lidhur me bisedimet e mundshme ndërmjet Kosovës dhe Unionit Serbi-Mali i Zi;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për shërbime postare-nr.2003/10;
4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe të mjedisit të punës-nr.2003/20;
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit legjislativ për amendamentimin e rregullorës së përkohshme të punës së Kuvendit;
6. Shqyrtimi i propozimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurial të Kosovës për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve; dhe
7. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare më 9 tetor 2003.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Procesverbali u miratua me vërejtjen e deputetës Edi Shukriu, se vërejtja e saj në procesverbalin e seancës së kaluar, duhet të jetë: "Ajo kërkoi që procesverbali të përfshijë frymën e diskutimeve substanciale dhe të mos përfshihen vetëm fjalimet e kryetarëve të grupeve parlamentare dhe të injorohen kontributet e vlefshme të anëtarëve tjerë të Kuvendit".

2. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë lidhur me marrjen e qëndrimit për bisedimet e mundshme Kosovë – Unioni Serbi Mali i zi.

Kryetari theksoi se do t'i informojë deputetët për kontaktet që ka pasur me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Kanë arritur edhe dy shkresa: një shkresë nga zoti Sollana, që është emituar në media dhe është e nënshkruar dhe, do të thoja, është një letër e mirë, por është edhe një shkresë, për të cilën, unë kam obligim t'ju njoftoj. E kam marrë edhe një shkresë tjetër nga Grupi i Kontaktit, dje pasdite, në të cilën është përmbajtja e njëjtë: kërkohet sjellje e përgjegjshme e përfaqësuesve në institucione. Përkujtohet se ne kemi marrë obligimet në Samitin e Selanikut në qershor dhe në një mënyrë shpjegohet ajo që mediat e kanë publikuar. Edhe bisedat tjera telefonike janë të këtij niveli dhe të kësaj përmbajtjeje

Ai e ftoi kryeministrin e Kosovës ta paraqesë propozimin e Qeverisë para deputetëve lidhur me këtë çështje.

Kryeministri Bajram Rexhepi tha se dialogu me Serbinë është njëri nga tetë standardet nga ish kryeadministratori Shtajner dhe të përkrahura nga institucionet relevante ndërkombëtare, Qeveria e Kosovës nuk e ka nënçmuar asnjëherë, por as nuk e ka predimensionuar. Kjo çështje, disa herë, është trajtuar në Qeveri, në mënyrë që nëse do të ketë dialog, të jemi sa më të përgatitur.

Me të drejtë kemi kërkuar vazhdimisht që të transferohen sa më tepër kompetenca në Qeveri, që të shtohen funksionaliteti dhe efektshmëria karshi pritjeve reale të qytetarëve të Kosovës, përmbushjes së standardeve, e në kuadër të tyre, edhe të dialogut, gjithashtu. Në këtë aspekt, deri më tani, kemi hasur në mosgatishmërinë e UNMIK-ut.

Me ardhjen e kryeadministratorit Hari Hollkeri, në takimin e parë zyrtar, më 26 gusht 2003, në formë të shkruar, ia kam dorëzuar kërkesat minimale për themelimin e disa zyrave në Kryeministri, si hap i parë drejt ministrive të ardhshme. Por, përveç premtimit gojor – se do të shqyrtohen seriozisht; dhe pas më shumë se dy muajsh, nuk kemi përgjigje decisive.

Me të drejtë kemi pritur se kryeadministratori i ri do t'i ketë prioritete problemet aktuale të cilat e rëndojnë Kosovën, si: zhvillimin ekonomik dhe gjetjen e rrugëve për huazime nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe perspektivën e hapjes së vendeve të punës; integrimin e komuniteteve minoritare; ngritjen e efektit të shërbimit policor dhe të gjyqësisë; respektimin e rendit dhe të ligjit; angazhimin e përbashkët për zgjidhje sa më të pranueshme për kategoritë sociale, arsimtarët, punëtorët shëndetësor, pensionistët, invalidët e tjerë.

Si e papritur, tërë energjia e tij është koncentruar në dialog me Serbinë, duke siguruar mbështetjen e institucioneve relevante ndërkombëtare. Ndërsa, për institucionet vendore, është menduar se është e vetëkuptueshme që ato do të marrin pjesë në dialog në çfarëdo forme, kohe dhe mënyre.

Qeveria e Kosovës, duke qenë e përgjegjshme ndaj Kuvendit dhe ndaj qytetarëve të Kosovës, në mbledhjen e rregulltë të 70-tën, ka marrë vendim njëzëri-të kërkojë nga Kuvendi i Kosovës që të marrë vendim politik lidhur me bisedimet e mundshme ndërmjet Kosovës dhe Unionit Serbi Mali i Zi.

Pikat e vetme të propozuara, qysh nga zoti Shtajner, dhe të aprovuara në Samitin e Selanikut, për momentin janë: kthimi i të zhvendosurve; personat e zhdukur; energjetika dhe transporti e telekomunikacioni. Dy nga këto pika janë plotësisht të rezervuara - kthimi dhe personat e zhdukur, ose të pagjetur. Ndërsa, energjetika dhe transporti janë përgjegjësi të gërshetuara ndërmjet institucioneve vendore dhe atyre të UNMIK-ut.

Kryeministri dhe Qeveria në përgjithësi nuk janë të gatshëm të marrin pjesë në bisedime me Beogradin pa një vendim pro të Parlamentit dhe, domosdoshmërisht, duke përfshirë konsensusin e tri grupeve parlamentare të subjekteve politike – nënshkruese të Marrëveshjes së 28 shkurtit 2002 për Qeverinë e Kosovës.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Sabri Hamiti theksoi se fjalimi i kryeministrit të Kosovës nuk është shumë i qartë se çka kërkohet sot prej Parlamentit. Unë kërkesën, pos mëdyshjeve rreth mundësisë së dialogut, kërkesën e qartë nuk e kuptova, totalisht. Në anën tjetër, thashë – unë nuk kisha përsëritur asgjë nga ajo që është thënë në këtë foltore para dy javësh. Vetëm ndiej nevojë që të saktësoj ose të ripërkujtoj disa gjëra, për hirë të nivelit të përgjegjësive të këtij institucioni, për hirë të zgjedhësve tanë, për hirë të opinionit.

Është mirë që të ritheksohen disa evidenca. Është mirë të dihet botnisht që përfaqësues të institucioneve të Kosovës, që nga Samiti i BE-s në Selanik e tutje, në mënyrë së paku deklarative publike, kanë thënë se – janë zotuar për dialog me fqinjët, natyrisht duke përfshirë edhe Serbinë dhe Malin e Zi, që është fqinji ynë. Kjo është nën një.

Nën dy. Këta përfaqësues të institucioneve, por edhe të partive relevante politike të Kosovës, saherë kanë biseduar me eksponentë të politikës ndërkombëtare, së paku publikisht, unë qysh i kam pa, kanë thënë se janë për këtë dialog.

Kuvendi ynë nuk ka arsye politike, të jetë kundër dialogjeve. Mirëpo, Kuvendi ynë është kaq i përgjegjshëm saqë: nëse dialogu është një standard i ashtuquajtur – i artikuluar nga Shtajneri, përkrahur nga institucionet tjera ndërkombëtare në Kosovë e jashtë saj, atëherë nëse standardi është një standard dialogu, atëherë edhe dialogu duhet të ketë standarde.

A i ka ky dialog standardet paraprake? Unë do të thosha: - jo. Një. Temat e propozuara, dy prej tyre, janë tema që unë, kujtoj, s'duhet të bisedohen hiq. Nëse nevojitet një dialog për një fotografi të përbashkët, si dëshmi se njerëzit mund të shihen në një tavolinë edhe të fotografohen, unë e konsidroj të padobishëm. Sepse, është lojë! Nëse është nevoja imanente e shoqërisë së Kosovës që të bisedohet për probleme të qytetarëve - po. .

Arsim Bajrami theksoi se Kosova e përkrah politikën e bashkëpunimit me të gjitha shtetet e rajonit, duke përfshirë këtu edhe Serbinë.

Mirëpo, Kosova po ecë shumë ngadalë në implementimin e Rezolutës 1244 dhe, do të thosha, në përgatitjen e saj për zgjidhjen finale të statusit të Kosovës, që është edhe një nga obligimet parësore të UNMIK-ut dhe të Kombeve të Bashkuara, pra për ta lehtësuar një zgjidhje politike, për një zgjidhje finale të statusit të Kosovës.

Dhe, në kushtet kur Kosova, shumë ngadalë po pajisjet me kompetenca dhe shumë ngadalë po merr përgjegjësi për të dëshmuar aftësitë e veta qeverisëse, nga Kosova kërkohet të hyjë në një proces me Serbinë, në kondita krejt të pafavorshme dhe të pabarabarta për dy arsye: për shkak se Serbia ka koncipuar një politikë shtetërore agresive ndaj Kosovës, duke kryer agresionin kushtetues përmes akteve kushtetuese. Dhe, për shkak se Kosova shkon me një pozicion shumë të pabarabartë, pra me pakompetenca dhe me një përfaqësim që, do të thoja, nuk është krejt i barabartë.

Në këtë kontekst, mendoj se duhet të shikojmë realisht – a është Kosova apo s’është e përgatitur për këto biseda.

Mendoj se ky Kuvend ka nevojë që edhe sot, por edhe në formë zyrtare dhe ligjore, të bëjë me dije edhe bashkësinë ndërkombëtare - edhe Serbinë edhe palët e tjera, që statusi final i Kosovës, do të thosha, implementimi i një vullneti politik plebishitar të popullit të Kosovës – është një çështje që do të vendoset ekskluzivisht nga populli i Kosovës, nga ky Parlament demokratik dhe në një bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar.

Mendoj se kushtet për një proces të dialogut me Serbinë nuk janë plotësuar.

Kështu, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, kërkoj që paraprakisht UNMIK-u, përmes zotit Hollkeri dhe me autoritetin e tij, të marrë vendimin për fillimin e menjëhershëm të bartjes së përgjegjësisë dhe kompletimin e strukturës qeveritare dhe strukturës tjetër institucionale të Kosovës në mënyrë që Kosova të jetë plotësisht e barabartë.

Parakushti i dytë: kërkojmë që Kuvendi i Kosovës t,i shpallë jovalide, inekzistente të gjitha këto veprime të njëanshme të Serbisë me të cilat po kryhen agresione kushtetuese.

Dhe, çështja e fundit, sa janë bërë përgatitjet efektive të Qeverisë së Kosovës për këto kontakte? Mendoj se nuk janë bërë dhe mungon një platformë e kurtë, e plotë, me strategji, me nënstrategji, me një përfshirje të ekspertëve e cila do të siguronte që Kosova të ketë një përfaqësim të denjë në këto kushte.

Dhe, së fundi, kërkoj që rreth kësaj çështjeje të thirret zoti Hollkeri edhe kryetari i Kosovës, që t’i drejtohet këtij Parlamenti në mënyrë që vërtetë të arrijmë konsensusin institucional, çfarë e kërkoi edhe kryeministri.

Dragisha Krstoviq theksoi se gjendja në Kosovë nuk është e mirë, as që ka gjasa që në një situatë të këtillë gjërat së shpejti të përmirësohen. Siguria dhe lëvizja e lirë për serbë, në shumë pjesë të Kosovës, fare nuk ekziston. Kthimi i të zhvendosurve thuaja se është i parëndësishëm. Fati i të rrëmbyerëve dhe i të kidnapuarëve nuk është zbardhur; institucionet e përkohshme të Kosovës nuk kanë bërë asgjë për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Deputetët e Koalicionit “Kthimi” i përkrahin të gjitha përpjekjet që i bën bashkësia ndërkombëtare që gjendja në Kosovë të përmirësohet dhe të krijohen kushte për jetë të qetë dhe të sigurt të të gjithë njerëzve që jetojnë këtu, dhe që dëshirojnë të kthehen këtu. Për këtë arsye mendojmë që bisedimet e bashkësisë shtetërore të Serbisë dhe Malit të Zi dhe të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës paraqesin rastin real për zgjidhjen e problemeve të këtilla dhe për kthimin e Kosovës drejt ardhmërisë më të mirë

dhe krijimit të kushteve për jetë të qetë dhe të sigurt për të gjithë njerëzit, që të kaluarën ta lëmë sa më larg - pas nesh dhe që, në çdo aspekt, t'u bashkangjitemi popujve dhe shoqërive të civilizuar të Europës dhe të botës.

Grupi i deputetëve të Koalicionit «Kthimi» i përshëndet përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për fillimin e bisedimeve dhe konsideron që është ky një rast për të bërë një kthesë të madhe sa i përket gjendjes të cilën e kemi dhe se bisedimet e vërteta dhe të sinqerta, mund të sjellin afrimin dhe pajtimin e të gjitha bashkësive në Kosovë, para së gjithash të bashkësisë shqiptare dhe serbe..

Ramush Haradinaj theksoi se përgatitjet për këto biseda teknike janë një improvizim për shumë shkaqe, për shumë arsye. Në radhë të parë, askush nga ne nuk ka një plan me detaje, me gjithçka, një skemë se si kishim me fillue.

Ne jemi deklaruar: kërkojmë një ndërmjetësues serioz, relevant ndërkombëtar; një adresë që, pastaj edhe pas takimit të parë simbolik, të dijmë kush është adresa jonë dhe kemi thënë se duhet të jenë përfaqësuesit e Qeverisë Amerikane. Dhe si mund ne t'i dhëmë mbështetje bisedave të këtylla kur kemi kaq paqartësi: është caktuar data, janë caktuar shumë çështje tjera, aspekte tjera, agjenda nuk dihet.

Edhe një aspekt tjetër, që i bën improvizim këto biseda. Improvizim në kuptimin e plotë të fjalës: Zoti Hollkeri thotë se ka ndërtuar “task fors”, pra ka ndërtuar një ekipë, një grup pune për me pasë sukses bisedat. Kush i zhvillon këto biseda, atëherë? A i zhvillon UNMIK-u, qeveria e UNMIK-ut apo Qeveria e Kosovës? Meqenëse ai nuk ka shprehë asnjëfijë rrespekti deri më sot, asnjë përfillje të njerëzve tanë të institucioneve, ne nuk mund të jemi të këtyllë që t'ua japim një “po” bisedave të kësaj forme.

Unë mendoj se Parlamenti i Kosovës nuk duhet t'i japë “po”-në Qeverisë përderisa Qeveria nuk sjell në këtë Parlament kërkesën për aprovim të Qeverisë së kompletuar. Kryeministri i Kosovës duhet të vjen në këtë Parlament me propozimin, me Qeverinë e kompletuar me të gjitha ministrinë dhe të kërkojë miratimin e programit të saj.

Pra, ju lus deputetë mos t' bëhi pjesë e veprimeve të dëmshme për ne dhe për këtë popull.

Sadik Idrizi theksoi se “bashkësitë e tjera” do ta përkrahin qëndrimin e shumicës në Kuvendin e Kosovës lidhur me dialogun eventual ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Bashkësitë e tjera dëshirojnë që, po qe se do të ketë dialog, të kyçen në te, sepse kanë probleme specifike. Në të kaluarën kemi qenë dëshmitarë që nga rradhët e bashkësive të tjera, për këto bisedime, njerëzit janë marrë nga rruga; ata nuk kanë qenë përfaqësues të kësaj bashkësie, për çka më vonë të gjitha bashkësitë kanë pasur probleme në këtë aspekt. Kjo ka ndodhur veçmas para luftës në Kosovë, me ç'rast, njerëzit jokompetent, të cilët nuk e kanë pasur as votën e popullit, janë ftuar për ta përfaqësuar atë popull. Kësaj here nuk dëshirojmë që të ndodhë një gjë e tillë, por dëshirojmë, po qe se do të kyçemi, të jenë përfaqësuesit të cilëve populli ua ka dhënë votën dhe që për këta përfaqësues të vendos Grupi parlamentar i bashkësive të tjera.

Xhavit Haliti theksoi se udhëheqësit e të gjitha partive politike, të institucioneve të Kosovës dhe të grupeve parlamentare janë deklaruar për dialog me shtetet fqinje. Kurse në anën tjetër, të gjithë përfaqësuesit e Serbisë janë deklaruar se do bisedojmë me “pjesën tonë”, me “krahinën tonë” dhe në asnjë mënyrë nuk do të bisedojmë me një vend fqinj.

Çështja e kërkesës së Qeverisë, unë mendoj se nuk është e plotë, për faktin se kur thuhet – do flasim për çështje të cilat janë ngritë: telekomi, transporti, njëra e tjetra. Mendoj se s’pari të zhdukurit dhe kthimi, unë mendoj nuk janë çështje për negociata. Nuk janë absolutisht çështje për negociata sepse edhe pala serbe, edhe pala shqiptare është e interesueme që këtë çështje ta zgjidhë.

Tani do të shtroja një çështje, për të cilën mendoj se ne në Kosovë kemi nevojë për një dialog të brendshëm dhe së pari duhet të fillojë dialogu në mes shqiptarëve, në mes të subjektit politik shqiptar.

Së dyti, mendoj që shqiptarët e Kosovës domosdoshmërisht duhet të fillojnë dialogun me koalicionin “Kthimi”, me serbët e Kosovës dhe t’i trajtojmë problemet, që ky koalicion a është duke punuar në Kosovë për interesat e Kosovës apo për një shtet fqinj?

Së treti, Kosova ka nevojë të fillojë dialogun me UNMIK-un dhe të merremi vesh për kompetencat të cilat ai duhet t’ia bartë institucioneve të Kosovës.

Prandaj, institucionet e Kosovës në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare do të duhej të kërkonim që me Serbinë ta nënshkruajmë një marrëveshje paqe në mes dy vendeve tona.

Kryetari theksoi se duke dëgjuar debatin e para dy javëve lidhur me këtë çështje, mendimet e grupeve parlamentare sot, fjalën shumë të përgjegjshme të kryeministrit – mendoj që Kuvendit të Kosovës i duhet edhe pak kohë që të marrë vendim për propozimin e Qeverisë, në mënyrë që ta ruajë unitetin funksional dhe veprues në institucione.

Prandaj, unë do ta përmbyllja këtë seancë për shkak të tensionimit të brendshëm të secilit nga ne dhe do t’i vazhdojmë ligjet në seancën e ardhshme plenare.

Kryetari e vuri në votim këtë propozim dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;

Kundër-----11;

Abstenime-----5.

Seanca përfundoi në orën 11:15 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik **Nexhat DACI**